



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Zl.Anr.212/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Hasan Shala anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Mitrovicë, për shkak të vendosjes së billboardit mbi rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ndërkaq subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Mitrovicë i shqiptohet dënimi më gjohë në vlerë prej 3 000 (tremijë) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. Urdhërohet subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), që brenda afatit prej 24 orëve nga pranimi i këtij vendimi, që ta përmirëson shkeljen e përcaktuar si në pikën I të këtij dispozitivi, në të kundërtën mund të sanksionohet me dënim shtesë.

A r s y e t i m

Me datën 13.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën kërkon rishqyrtimin e vendimit ZL.Anr.94/2017 të datës 03.10.2017, sepse sipas tyre AKR në përgjigjen për ankesën për rastin e lartcekur, kanë thënë se kinse i kanë larguar banerat nga vendet e palejuar, gjë e cila nuk është e vërtetë pasi që të njëjtit banerë i kanë larguar vetëm nga sheshi kryesorë i qytetit të Mitrovicës me ndërsa me dhjetëra banerë të tjerë edhe sot janë të vendosur nëpër rrugët kryesore të qytetit, si në rrugën “Mbretëresha Teutë”, në rrugën “Shemsi Ahmeti”, dhe në rrugën “Ukshin Kovaqica”.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur 5 fotografi lidhur me rastin në fjalë. Në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik AKR, të datës 14.10.2017, kanë theksuar se lidhur me vendimin ZL.Anr. 94/2017 të datës 03.10.2017, PZAP-i ka hedhur poshtë ankesën e PDK-së, ndërsa lidhur me ankesën ZL Anr.212/2017 të datës 13.10.2017 nuk kanë pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se për të njëjtën shkelje PZAP-i ka vendosur me vendimin ZL.Anr. 137/2017 të datës 10.10.2017, me të cilin vendim ka gjobitur AKR-në me 5.100.00 euro.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se banerët e kandidatit për kryetar të Komunës së Mitrovicës, nga radhët e subjektit politik AKR ende janë të vendosur mbi rrugë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila

përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se e njëjti janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe përkundër faktit, që është vendosur dhe dënuar me gjobë për të njëjtën shkelje në vendimin ZL.Anr 137 i njëjti subjekt nuk ka ndërmarr asnjë veprime për evitimin e shkeljes. PZAP-i ia dha mundësinë për tu përgjigjur dhe urdhëroi që të eliminoj shkeljen mirëpo i njëjti nuk ka ndërmarr asnjë veprim për evitim të shkeljes dhe për këtë arsye ka pasuar sanksioni tjetër me gjobë. Në përgjigjen e parashtuar nuk janë ndërmarrë masa përmirësuese, duke arsyetuar se për të njëjtën shkelje PZAP-i ka vendosur me vendimin ZL.Anr.137/2017 të datës 10.10.2017, me të cilin vendim është gjobitur subjekti i tyre AKR. Mos ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi .

Paneli konform nenit 120.1 pika a) të LZP-së urdhëroi subjektin politik AKR që të marrë masa dhe të përmirësoj shkeljen në afatin prej 24 orëve afatin prej dhe nëse subjekti politik AKR nuk vepron sipas urdhrit të panelit do të pasoj sanksioni tjetër.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.212 /2017 më datën 16.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.